

JURIDIK I PËRGJITHSHËM - VITI I TRETË- SEMESTRI V

E Drejta e Procedurës Penale – pjesa e përgjithshme [O]:

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentët të aftësohen në konceptet e përgjithshme të nocioneve, institucioneve dhe parimeve kryesore të së drejtës penale, subjektet e procedurës penale, kompetencat e subjekteve, veprimet procedurale, procedurat e veçanta penale, afatet në procedura penale, rolin e prokurorit publik dhe policies, në procedurat penale, masat e fshehta kundër kryerësve të veprës penale, etj

E Drejta e Procedurës Civile I [O]:

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentët të pajisen me njohuritë e duhura mbi të drejtat e procedurave civile, detyrat e legjislacionit procedural civil, parimet kryesore të legjislacionit procedural civil, marrëdhëniet juridike procedurale civile në mes të palëve dhe gjykatave, thirrjet në gjyq dhe shpenzimet gjyqësore, etj.

E Drejta e Bashkimit Evropian [O]:

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentët pas përfundimit të këtij kursi, të aftësohen në të drejtat e Bashkimit Evropian, strukturat organizative juridike të BE-së, Marrëveshja e Lisbonës, institucionet dhe burimet formale juridike të BE-së, traktet përkatëse të BE, protokollet dhe marrëveshjet, vendimet e gjykatave, rregulloret substanciale, lëvizja e lirë e mallrave dhe e personave, konkurrenca e pandershme, dispozitat mjedisore, sociale dhe të drejtat e njeriut, politikat tregtare, etj

E Drejta e Procedurës Administrative [O]:

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentët të njohohen me nocionet, institutet, subjektet dhe parimet kryesore të së drejtës së procedurës administrative, konfliktet administrative dhe procedurës kundërvajtëse. Studentët do të jenë në gjendje në mënyrë të argumentuar t'i diskutojnë konceptet e mësuara, të vlerësojnë kompetentësinë dhe rregullsinë e vendimeve relevante administrative.

Krimi i Organizuar [Z]:

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentët të aftësohen me njohuritë e duhura mbi krimin e organizuar, elementet e krimit të organizuar, format e krimit të organizuar, aspekti juridiko-penal i krimit të organizuar, fenomenologjia e krimit të organizuar, etiologjia e krimit të organizuar, duke analizuar edhe nga afër në mënyrë kritike nga perspektivat sociale, grupe të tilla si: afro-amerikane, meksikane, aziatike, kolumbiane, afrikane, ruse, etj.

Krimet Kibernetike [Z]:

Qëllimet e kësaj lënde janë, që studentët pas përfundimit të kësaj lënde, të jenë në gjendje të kuptojnë për së afërmi krimet kibernetike të kohës së sotme, të shohin se si ndikojnë krimet kibernetike në punët dhe përgjegjësitë e personave të sulmuar. Studentët do të zhvillojnë metodologji në analizimin dhe dokumentimin e krimeve kibernetike, të shohin se si janë shkeljet e pronësisë intelektuale, rreziqet e sigurisë, krimi në internet, vjedhjet e identitetit, privatësia, etj.

E Drejta Penale Ndërkombëtare [Z]:

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentët të pajisen me njohuritë e duhura mbi të drejtën ndërkombëtare penale, të forcojnë konceptin e sistemit të përgjithshëm juridik vendor e ndërkombëtar, të drejtës penale në përgjithësi, të drejtës penale të krahasuar dhe asaj në veçanti. Të aftësohet në parimet dhe dispozitat tjera adekuate që mbrojnë vlerat njerëzore dhe të shoqërisë, luftimin e krimit, mbrojtjen e paq.eës, rendin ndërkombëtar, etj.

JURIDIK I PËRGJITHSHËM - VITI I TRETË- SEMESTRI VI

E Drejta Biznesore [O]:

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentët të njohohen me të drejtat biznesore të përcaktuara me ligjet vendore dhe ndërkombëtare. Të njohohen me burimet dhe bazat juridike-biznesore, raportet dhe subjektet juridike-biznesore, bankrotimi dhe likuidimi i subjekteve juridike, punët juridike-biznesore, etj.

E Drejta e Bashkimit Evropian II [O]:

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentët të pajisen me njohuritë e duhura mbi të drejtat e Bashkimit Evropian, duke u thelluar në strukturat organizative të Bashkimit Evropian, marrëveshjet, institucionet dhe burimet formale juridike të Bashkimit Evropian, traktatet, protokollet, vendimet gjyqësore, rregulloret substancionale, etj.

E Drejta e Detyrimeve [O]:

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentët të aftësohen në raportet me të drejtën e detyrimeve, parimet e të drejtës së detyrimeve, subjektet në të drejtën e detyrimeve, raportet detyrimore mes palëve, kontaktet, palët e kontratave në raport detyrimor, llojet e kontratave, në raport detyrimor, etj.

E Drejta Ndërkombëtare private [O]:

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentët të njohohen me ndarjen dhe dallimin mes marrëdhënieve juridike – civile dhe marrëdhënieve juridike – civile, me element të huaj, të njohohen me burimet e së drejtës ndërkombëtare private, mënyrat e rregullimit të marrëdhënieve juridike-civile, me elemente të huaja, mënyra karakteristike e rregullimit vetëm për DNP, etj.

Shkrim Ligjor [Z]:

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentët të aftësohen në shkrimin dhe arsyetimin juridik të normave dhe akteve juridike, teknikat e mira të shkruarit të kushtetutës, ligjeve, akteve nënligjore, kontratave, testamenteve, vendimeve gjyqësore, vendimeve administrative, kërkesave, konkurseve, shpalljeve publike, ankesave, padive, memorandumeve, procesverbaleve, autorizimeve dhe shumë shkresa të tjera juridike.

E Drejta e TI [Z]:

Qëllimet e kësaj lënde janë, që studentët pas përfundimit, të njoftohen me të drejtat e TI – Teknologjisë Informative, se çfarë të drejtash kanë mbi përdorimin e mjeteve dhe proceseve të Teknologjisë Informative, të drejtat e autorit të një krijimi softwerik, të drejtat e përdorimit të një kodi-burimor, të drejtat e dërgimit dhe pranimit të të dhënave në internet, që kërkohen gjatë hapjeve të llogarive dhe punëve në internet.

E Drejta e Mjedisit [Z]:

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentët të avancohen në të drejtat që i përkasin mjedisit. Do të njoftohen me aktet ligjore që parandalojnë shkatërrimet e ndryshme mjedisore, qofshin natyrore ose objekte ndërtimore, t'i shohin proceset ligjore për ndëshkimet dhe parregullësitë e shumta që ndodhin në mjedisin tonë, duke i krahasuar me aktet ligjore ndërkombëtare.